



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA FIER**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Fier, më 31/ 03/ 2021

**Lënda:** Formulari i Njoftimit të Fituesit për procedurën me objekt “**Rehabilitimi i pjesës jugore të unazës Skënderbej**”, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**  
**TIRANË**  
**(për botim)**

---

**BASHKIA FIER**

**Për:** Operatorin ekonomik “**MODESTE**” shpk  
Adresa: Lagja “1 Maji”, Fier.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur me mjete elektronike.**

Numri i referencës së procedurës / lotit: **REF-86408-02-09-2021.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rehabilitimi i pjesës jugore të unazës Skënderbej**”, me fond limit **20 823 184** (njëzetë milion e tetëqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH lekë**, në përputhje me Projektin, Preventivin dhe kushtet e përcaktuara në DST. Afati kohor për ekzekutimin e punimeve: jo më vonë se **12** (dymbëdhjetë) **javë**. Objekti do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë brenda grafikut të punimeve, por financimi do të bëhet në 2 (dy) vite buxhetore (2021, 2022), perkatesisht në shumat 10 000 000 leke me TVSH për vitin 2021 dhe diferenca e mbetur për vitin 2022.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [15 Shkurt 2021], [Numri 21].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët- **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**MODESTE**” shpk numri i NUIS J62903413B.  
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **14 646 191.09 lekë pa TVSH.**
2. Operatori ekonomik “**2N**” shpk numri i NUIS L31615017L.  
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **14 253 707 lekë pa TVSH.**
3. Operatori ekonomik “**EURONDËRTIMI 2000**” shpk numri i NUIS K02003001O.  
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **14 392 499 lekë pa TVSH.**
4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “**SPEKTRI**” shpk numri i NUIS J62903555F & “**ARDIT-06**” shpk numri i NUIS K63027403V.  
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **15 456 304 lekë pa TVSH.**
5. Operatori ekonomik “**DESARET COMPANY**” shpk, numri i NUIS K01816001J.  
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **17 083 609 lekë pa TVSH.**
6. Operatori ekonomik “**SHENDELLI**” shpk, numri i NUIS K07924803N.  
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **17 502 636 lekë pa TVSH.**
7. Operatori ekonomik “**SARK**” shpk numri i NUIS K52531415H.  
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **18 346 856 lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**2N**” shpk numri i NUIS L31615017L.
2. Operatori ekonomik “**EURONDËRTIMI 2000**” shpk numri i NUIS K02003001O.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. OE “2N” shpk nuk provon përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST, pasi nuk ka paraqitur punë të ngjashme të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit. Edhe referuar zerave te ngjashem te situacionit te kontrates se paraqitur me objekt “Strukture magazinimi 1 kat dhe mur rrethues”, vlera e tyre nuk permbush vlerën e kerkuar ne DST per plotesimin e ketij kriteri, pasi nuk ka paraqitur punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Kartela personale e sigurimit teknik per punonjesin me specialitetin e kerkuar bojaxhi i OE 2N, nuk eshte e vlefshme, pasi i ka perfunduar (skaduar) afati (periudha), dokument i cili eshte ne kundershtim me piken 2.3.4, paragrafi i tretë, rubrika 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST, ne te cilen percaktohet se “Specialistet e sipercituar sipas profesioneve, duhet të jenë të pajisur gjithashtu edhe me të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013”.

2. OE "EURONDËRTIMI 2000" shpk nuk provon përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet në piken 2.3.1, të rubrikës 2.Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 12 të DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë punë të ngjashme të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit. Kontratat e paraqitura në SPE nga OE për këto procedura prokurimi, janë kontrata publike me objekt rikonstruksion apo sistemim asfaltim rrugësh, të cilat nuk vlerësohen punë të ngjashme me objektin e prokurimit, të ekzekutuara nga subjekti ofertues për të përmbushur kërkesat e pikës 2.3.1. të kërkesave për kualifikim, në respektim edhe të rregullave të prokurimit publik.

OE "EURONDËRTIMI 2000" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim "Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin 2020, pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB", të percaktuar në piken 2.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 12 të DST.

Bazuar në kriteret e percaktuara në DST si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, referuar kontratave për zbatimin e punimeve të deklaruara nga vet subjekti ofertues EURONDËRTIMI 2000 shpk sipas dokumentit "DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES", rezulton se OE ofertues EURONDËRTIMI 2000 shpk ka nënshkruar kontrata publike me autoritete kontraktore për punë publike përgjatë vitit 2020, për të cilat në bazë të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", neni 3.1/a,b,c dhe neni 40, në Ligjin nr.131/2015 "Për QKB", si dhe në Ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR", mbart detyrimin të hap NIPT dytesor, të deklarohet dhe të regjistrohet në QKB, si dhe të paraqiste në këto tender vërtetimet për shlyerjen e taksave vendore në njesite e qeverisjes vendore në të cilat ka ushtruar apo ushtron aktivitet, konkretisht kontrata me FSHZH për objektin "Rehabilitim i rrugëve Shesheve e fasadave Blloku Lagja Nr 2 Pogradec" (Bashkia Pogradec) e datës 02.11.2020. Subjekti ofertues EURONDËRTIMI 2000 shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për shlyerjen e taksave vendore në Bashkinë Pogradec, në përputhje me piken 2.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 12 të DST. Kontrata me Bashkinë Durrës për objektin "Loti 9: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në zonën e Shkëmbit të Kavajës, në kuadër të procesit të rindërtimit" e datës 12.10.2020. Subjekti ofertues EURONDËRTIMI 2000 shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për shlyerjen e taksave vendore në Bashkinë Durrës, në përputhje me piken 2.2.3, të rubrikës 2.Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 12 të DST.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**MODESTE**" shpk numri i NUIS J62903413B, Adresa: Lagja "1 Maji", Fier, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **14 646 191.09 lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Njesisë së Prokurimit të Bashkisë Fier, Lagja "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi"**, sigurimin e kontratës dhe të nënshkruani kontratën, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **19.03.2021**.

Ankesa: ka ose jo, - **JO**.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë:

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Armando SUBASHI**